

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“OPTASIA” SHPK

Sot, më datë 29.07.2024, në Tiranë, në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqërите tregtare”, të ndryshuar, si dhe me parashikimet, e Ligjit nr. 55/2018, ne te nenshkruarit:

Alban Ademaj, shtetas shqiptar, lindur në Kukës, më 29 prill 1990, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034073870, dhe nr. personal J00429099C, banues në Tiranë, në: Ish-Fusha e Aviacionit, Rezidencia Turdiu, kati 7, Apartamenti 8,

Enxhi Cerpia, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 07 Shkurt 1994, mbajtës i letërnjoftimit nr. 036251695, dhe nr. personal J45207052A, banuese në Tiranë, në: Rruga Gjin Bue Shpata

Ne cilesine e Ortakeve te Shoqerise me përgjegjesise te kufizuar vendosim të krijojme shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar **“OPTASIA” SHPK**, Akti i Themelimit të së cilës hartohej me këto kushte:

Neni 1
Emërtimi

Shoqeria është person juridik privat dhe vepron si shoqeri me përgjegjësi të kufizuar. Ajo do të paraqitet në qarkullim me emrin **“OPTASIA” SHPK**.

Neni 2
Baza ligjore

Shoqeria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

Neni 3
Forma ligjore

Shoqeria është me përgjegjësi të kufizuar, por mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Afat i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

Neni 5

Selia

5.1.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rr. Andrea Kushi, Ish-Fusha e Avacionit, Rezidencia Turdiu, Kulla A, katë 7, Apartamenti 8, Tiranë, Shqipëri.

5.1.2 Shoqëria mund të hapë degë apo zyra përfaqësie, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Objekti i veprimtarisë

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- i. **Planifikim i Eventeve:** Organizimi dhe koordinimi i të gjitha detajeve për ngjarje të ndryshme si konferanca, festat private, Evente (Korporative, Inagurime, Pervjetore), Seminare, Trajnime, fushatave promocionale, etj.
- ii. **Menaxhimi i Logistikës:** Sigurimi i transportit, organizimi I sheshit, infrastrukturës së nevojshme si tenda, mobilje, pajisje audio-vizuale, dekorë te ndryshme
- iii. **Marketing dhe Promovim:** Zhvillimi i strategjive të marketingut për të promovuar eventin, përfshirë mediën sociale, PR, dhe reklama tradicionale.
- iv. **Catering dhe Menaxhimi i Ushqimit:** Organizimi i shërbimit të ushqimit dhe piyeve për evenete të mëdha ose të vogla, duke përfshirë menutë dhe shërbimin e kuzhinierëve profesionistë, kamarierëve
- v. **Teknologji dhe Audio-Vizual:** Furnizimi i teknologjisë së nevojshme për mbështetjen e prezantimeve, ekranëve të projeksionit, sistemeve të zërit, audio, sherbim video dhe fotografi.
- vi. **Koordinimi i ekipit dhe personelit:** Menaxhimi i ekipit të punëtorëve të eventeve, duke përfshirë stafin e sigurisë, stafin teknik, dhe personelin e shërbimit të klientëve.
- vii. **Konsultim dhe Këshillim Strategjik:** Ofrimi i këshillave strategjike për të maksimizuar efektivitetin dhe impaktin e evenitit, duke përfshirë analizën e buxhetit dhe rekomandimet për përmirësimë.

- viii. **Mbështetje e Administratës dhe Koordinimit të Regjistrimit:** Organizimi i proceseve të regjistrimit, menaxhimi i informacionit të pjesëmarrësve dhe koordinimi i logistikës së dokumentacionit.
- ix. **Eksperiencë dhe dizajn i ngjarjeve:** Krijimi i një eksperiencë të personalizuar për pjesëmarrësit, duke përfshirë dizajnin e ambienteve dhe kriimin e atmosferës së përshtatshme për temën dhe natyrën e eventit.
- x. **Mbështetje Pas-Event:** Vlerësimi dhe analiza e performancës së eventit, përgatitja e raporteve të pas-eventit dhe rekomandimet për evenete të ardhshme.
- xi. Ofrimi i shërbimeve të shitjes me pakicë dhe me shumicë të artikujve promovues, si dhe printimeve dhe magazinimit. Krijimi i video animacioneve dhe dizajnit grafik. Prodhimi dhe montimi i reklamave për ambiente të brendshme dhe jashtëm.
- xii. Ndertim edhe mirembajtje software dhe website, krijim rrjeti kompjuterik dhe serverash, sisteme audio, sisteme kamerash edhe mirembajtje e tyre

6.2 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 7 Kapitali themeltar

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (një qind) lekë.

7.2 Kapitali i Shoqërisë do të ndahet në 2 (dy) kuota, me vlerë nominale 50 (pesedhjete) lekë. Ortakët do të zotërojnë përkatësisht:

- Alban Ademaj 50 % (pesedhjete) për qind të kapitalit;
- Enxhi Cerpia 50 % (pesedhjete) për qind të kapitalit;

7.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer nga ortaket e shoqërisë.

Neni 8 Transferimi i pjesëve të kapitalit

8.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme më rrugë të trashëgueshme, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.

8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme tek të tretët, vetëm pas miratimit nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 9**Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit**

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 10**Asambleja e ortakëve**

Asambleja e ortakëve merr vendime sipas parashikimeve të Statutit të Shoqërisë.

Neni 11**Administratori**

11.1 Shoqëria ka një administrator i cili do të jetë Alban Ademaj, shtetas shqiptar, lindur në Kukës, më 29 prill 1990, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034073870, dhe nr. personal J00429099C, i cili emërohet për një periudhë 5 vjeçare. Detyrat dhe kompetencat e tij përcaktohen në Statut.

11.2 Administratori emërohet, zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë në përputhje me kërkesat e Statutit.

Neni 12**Kontrolli financiar**

Shoqëria mund të caktojë ekspert kontabël për kontrollin financiar të saj.

Neni 13**Viti financiar**

13.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të çdo viti.

13.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor 2024.

Neni 14**Dividendi**

Shoqëria do t'i shpërndajë ortakëve të saj të gjithë fitimet që mund të arrihen pasi të ketë përbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe detyrimet për mbajtjen e rezervave të domosdoshme dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

Neni 16
Likuidimi

Likuidimi i Shoqërisë vendoset nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 17
Dispozita mbyllëse

Ky Statut hartohet në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe më fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKET E SHOQËRISË:

Alban Ademaj

Enxhi Cerpia

Alben Ademaj


Enxhi Cerpia
